

**THE THEME OF THE KOSOVO WAR IN ALBANIAN POETRY 2000 -
2010**
TEMA E LUFTËS SË KOSOVËS NË POEZINË SHQIPE 2000 - 2010

Shkurtë KADRIU-ÇITAKU¹

**Corresponding author e-mail: shkurta1@gmail.com*

Hyrje

Përfundimi i luftës, pavarësia e Kosovës i dhanë një vulë edhe poezisë sikurse fushave të tjera, ndikimi i këtyre rrethanave nuk është që s' u pa si interferim edhe në fushën e poezisë. Një përvojë të tillë të shkrimit të poezisë për këtë temë e gjejmë edhe të autorët të cilët shkruajnë gjatë kësaj periudhe, sepse dhjetëvjetëshi i parë i pasluftës së fundit në Kosovë krijon poezinë më shumë si evokim kujtimesh dhe sekuencash lufte të viteve 1998-1999 të Kosovës (Ali Podrimja, Sabri Hamit, Rrahman Dedaj, Ramadan Musliu, Sali Bashota, Basri Çapriqi, Osman Gashi, Halil Matoshi etj.), me përjashtim të ndonjë autori të ri i cili i qëndron indiferent kësaj teme për të shtrirë korpusin letrar në dimensione të reja tematike të poezisë.

Pra, shohim se ky dhjetëvjetësh në shumicën e botimeve përcillet me poezi të botuara para luftës që krijojnë poezinë përveç si dëshmi “dokument”, edhe si vlerë poetike që shpërthen fuqishëm duke u shkruar diku në rrethana lufte e diku e përpunuar apo evokuar në rrethana paqeje në Kosovë. Pra, kolazhi i poezisë së Kosovës i shkruar në vitet 2000-2010 është “ngatërruar” edhe me vitet '90 ku në secilin botim të autorëve gjen poezi dhe tema të nënshkruara nga vetë autorët me data të viteve '90. Poezia e këtyre viteve jep shenja identifikuese të nacionit në letërsinë e Kosovës dhe e dallon atë si poetikë e ndërtuar shpeshherë me tema të mëdha siç janë: atdheu, lufta, paqja, dashuria etj.

Poezia mision/estetikë – (dhjetë vjetëshi i poezisë së luftës)

Poetët si Rrahman Dedaj (1939-2005), Ali Podrimja (1942 - 2012), Nexhat Halimi (1949), Sabri Hamiti (1950), Ramadan Musliu (1954 - 2020), Sali Bashota (1959), Basri Çapriqi (1960- 2018), Naime Beqirajetj., janë autorë të cilët poezinë e shkruajnë edhe më herët e ndiejnë si sprovë të tejkohësisë duke ikur shpesh nga rrethanat e jetës, si ato të luftës së fundit në Kosovë (1999), përkundër që shkruajnë edhe për këtë periudhë kohore. Poezia e tyre kap temën më shumë si dimension estetik, por edhe atëherë kur nuk mund të ikin nga konteksti i japin ngjyrim të madh estetik poezisë.

Duke qenë se janë autorë që kanë shkruar shumë përmbledhje para viteve 2000, poetika e poezisë së tyre është e stabilizuar mirë, prandaj, secili prej këtyre autorëve ka arritur ta ndërtojë stilin e tij të veçantë, figuracionin e tij të veçantë, mënyrën e veçantë të trajtimit të temave etj., duke krijuar bagazhin e tij poetik në këtë korpus letrar.

Rrahman Dedaj, “Zoti thotë ndryshe Adam” (2006) – Rrahman Dedaj është poet që poezinë e krijon si situatë rrëfimi në kohë dhe rrethana të ndryshme, nëpërmjet stilit dhe figuracionit karakterizues që e veçon poezinë e tij. Prania e elementeve dalluese në aspektin figurativ shihet më shumë si figurë etnie e nacioni, që japin rrethanat kohore të zhvillimeve gjatë viteve kur është shkruar dhe botuar “Zoti thotë ndryshe Adam”.

Tema e luftës (vitet 1999) dhe e atdheut është e pranishme në poetikën e Dedajt, diku si evokim kujtimesh, diku si sekuencë ngjarjesh, diku si përjetim etj. Një pamje e përbotshme të Dedaj na del edhe në poezinë e debimit të shqiptarëve nga Kosova në vitin '99: “Kosova kurrë s’ka udhëtuar më shumë/ Me trena, vetura, kamionë./ Në krytragjedinë origjinale / Kurrë kaq shumë spektatorë.”²⁹¹ Të shkruara në këtë frymë janë edhe poezitë “Ndoshta somnabul”, “Baladë e së shtunës”, “Fragmente nga letra e mikut tim poet”, “Atdheu prej shiu”, “Ora kobëtare”, “Nisje” etj., duke trajtuar temën e luftës së fundit në Kosovë përveç si kujtim shpesh edhe si përjetim aktual.

Rrahman Dedaj që teksti të jetë më ekspresiv në teknikën e shkrimit të poezisë së tij fut në praktikë edhe vargun si formë dialogu, si te poezia “Dialog i pakryer” që zhvillohet në vetën e parë dhe të tretë: “Unë: Po i rriten flokët mërgatës / Ai: do të hamë bukë durimi”²⁹²

Figuracioni i veçantë i Dedajt, temat e motivet origjinale të tij, si dhe mjetet e tjera artistike të tij, janë të pranishme kudo në poezi, herë të theksuara më shumë e herë më pak, po në funksion të poezisë, e cila edhe kur flet për atdheun nuk është patetike, por me maturi dhe refleks të një njeriu të matur e meditant, nga niveli i poetit me përvojë në poezi. Në këtë radhë kemi poezinë e Dedajt i cili tragjicitetin e shpërnguljes së shqiptarëve me dhunë nga Kosova arrin ta sublumojë në varg me estetikë të lartë në poezinë e tij: “Vuri kokën mbi gjunjë / Ëndërron zogj të kaltër / Qiellit që na mungon.”²⁹³ Thënë troç tema e atdheut, e luftës, e vendlindjes janë tema që nisin e sosin librin poetik “Zoti ka thënë ndryshe Adam”.

Ali Podrimja, “Libri mbi të qenit” (2009) – Ali Podrimja në librin poetik “Libri mbi të qenit” ka të përmbledhura poezi të para dhe pas luftës së fundit të Kosovës. Në poezinë e Podrimjes nuk mungojnë asnjëherë vargje me motive tipike shqiptare, të cilat i japin një shtyrje të fortë poezisë sonë si poezi autentike, me simbolikë dhe figuracion të identifikueshëm si nacion i veçantë. Prania e fjalës së popullit pothuajse gjithmonë ndihet në poetikën e tij, diku si më e theksuar e diku më pak. Një simbolikë e veçantë me plot figuracion që del si fjalë e urtë popullore është edhe poezia “Pasaniku e ka qenin”: “Hajni ia mësyen fukarasë / se pasaniku / e ka qenin”²⁹⁴

Në këtë libër një vend të veçantë zënë poezitë e shkruara gjatë viteve '90, të cilat shquhen me tema lufte, evokime kujtimesh të përjetuara në atë kohë. Poezitë “Imazh i zymtë”, “Mes dy gurëve”, “Ferri humbi kuptimin”, “Atdheu, dhembje” etj., japin tabelën e kontekstit të lartshënuar me emërtime simbolike që paraqesin gjendjen e rëndë të asaj kohe në këto poezi duke u nisur edhe që nga titulli i tyre. Në disa raste, Podrimja në këtë libër poetik trajton temën e atdheut shikuar nga pozicioni i jetës së përbashkët dhe të dhunshme që shqiptarët e jetonin në raport me armikun gjatë viteve '90.

²⁹¹ Dedaj, Rrahman, *Vepraletrare 3*, Faik Konica, Prishtinë, 2008, f. 232.

²⁹² Po aty, f. 334.

²⁹³ Po aty, f. 334.

²⁹⁴ Podrimja, Ali, *Librimbitëqenit*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 104.

Këtë ide e realizon shumë mirë përmes jetës së përbashkët të shqiptarëve me ujkun, që simbolizon egërsirën, si te poezia “*Udhëtim me ujq*” e shkruar në vitin 1992 që ka një simbolikë të fuqishme: “*Ai që nuk ka bërë udhë me ujq / nuk di ç’është liria / as këmisha e yjeve*”.²⁹⁵ Poezitë e Podrimjes në “*Libri mbi të qenit*”, të shkruara gjatë viteve 2000, kanë fuqi të njëjtë artistike. Një model që i shton bukurinë vargut të Podrimjes në këtë libër poetik janë edhe poezitë kushtuese, si: “*Lamtumirë president i Dardanisë*”, “*Ajo që nuk vdes*” (Nipit, Gent Salihut) etj. Ky autor me mjeshtëri të madhe arrin t’i ndërtojë këto poezi që rrinë bukur edhe jashtë kontekstit konkret të njerëzve që ua kushton, me figuracion, kombinatorikë ngjyrimesh poetike si te vargu: “*Frymon atdheu, paska Zot*” i poezisë kushtuar Visar Zhitit, shkruar më 2008: “*Putha pikën e gjakut / Mes Qiellit e Tokës / Më mbuloi drita hyjnore / Guri ia lëviz, rrënja / Frymon atDheu, paska Zot*”.²⁹⁶

Pjesa tjetër e poezive të shkruara gjatë viteve 2000 në “*Libri mbi të qenit*” janë poezi me temë dashurie, si poezia “*Qan një vashë në Romë*”: “*Në Romë qan një vashë dhe mallkon/ ditën kur e pa flokëverdhin / Tek zbritë nga Liburna ilire / në dhera vullkanike*”²⁹⁷ Podrimja temën e dashurisë e lidh aq bukur në poezinë e tij, sa që krijohen variante tematike brenda kësaj teme, kështu që diku na dalin si variante dashurie brenda një poezie, diku tema e dashurisë del e kombinuar me temën e atdheut, është një labirint që e ka të vështirë daljen, duke u nisur nga aspekti tematik. Prandaj, ky gërshetim temash jep kurorën tematike më shumë si temë dashurie e shikuar në kuptimin e përgjithësuar.

Prania e viteve 2000 - 2010 si kontekst socio-politik i Kosovës, ndihet i pranishëm te poezia e Podrimjes në tërësi. Në shumë poezi shohim të shfaqur turbullirat shpirtërore të poetit, mospajtimin me rrethanat e kohës, pakënaqësitë shpirtërore të subjektit lirik etj. E tillë na del poezia “*PSALM*” e shkruar në vitin 2007: “*Në horizont duket ëngjëlli i zi / Nuk prajnë të lehurat as krrokamët / Të pështyjë tim Zot mos është koha*”.²⁹⁸

Poezia e Podrimjes, si te përmbledhjet e tjera, edhe në këtë përmbledhje ndërtohet ashtu që të jetojë gjatë si nga aspekti estetik, ashtu edhe nga aspekti tematik.

Nexhat Halimi “*requim për fluturën*” (2004) – Nexhat Halimi është poet që poezinë e shkruan me figuracion të ngjeshur në vargjet si tregime për atdheun ku ndërtohen me tonalitete estetike e artistike duke theksuar shtrirjen tematike për atdheun, vendlindjen, luftën e viteve ‘99, ku ndihen dëshirat, mungesat, malli, vendlindja etj. Në poezitë e Halimit natyra poetike mundohet të ikë nga tonalitete të ashpra me vargje deklarative e revoltuese, ajo shprehet më shumë si estetikë se sa si varg pankartë, por, me refleksin e një rrëfimtari të qetë që bën edhe pyetje retorike për të dalë nga situata të përkeqësuar. Pra, pakënaqësia në poezinë e Halimit nuk krijon lajmin e një “shtypi ditor”, por ndjek formën e shkrimit që mëton të jetojë më gjatë. Me këtë fuqi është poezia “*Hia e rrushi*”: “*A do të pëlcase kafazi të fluturojë zogun*”.²⁹⁹

Vargu i Halimit familjarizohet me figuracionin dhe i rri bukur temës e poezisë. Ana estetike e figurative nuk e dhunon poezinë por mishërohet lehtë me të duke ndier rrjedhshmërinë e natyrshme të inkorporimit të elementeve temë - figurë që ndihen kudo në poezinë e tij. Me ritëm konstant dhe figuracion të dukshëm Halimi dallon nga poetët e tjerë dhe i qëndron besnik mënyrës dhe stilit në të shkruar. Fyelli, gjaku, molla, flutura janë figurat që e përcjellin poezinë e Halimit nga fillimi deri në fund të “*requiem për fluturën*”.

²⁹⁵ Po aty, f. 125.

²⁹⁶ Po aty, f. 131.

²⁹⁷ Po aty, f. 111.

²⁹⁸ Po aty, f. 50.

²⁹⁹ Halimi, Nexhat, requiem përfluturën, Qendra e Kulturës, Podujevë, 2004, f. 35.

Në secilin cikël apo secilën ndarje poezitë e Halimit nisin me një kolazh që i dallon renditja numerike dhe shihet intenca për të krijuar një parathënie apo hyrje për ciklin vijues.

Loja në teknikën poetike të Halimi shihet në shumë poezi, të cilat janë të ndara me numër, të emërtuara secila me nga një titull ku vargu i fundit përsëritet në vargun e parë të poezisë pasuese, me këtë kuptojmë se Halimi krijon e ndërton vargun me teknikë e stil të veçantë duke vënë në shprehje artistiken përveç si figuracion edhe si formë që lidh përmbajtjen me vizualen.

“*requiem për fluturën*” është një program i analizuar mirë që jep ndjesinë e meditimit nëpërmjet vargut.

Sabri Hamiti, “Sympathia” (2004) - Në librin “*Sympathia*” poezia e Sabri Hamitit përshkohet nga tema dhe motive me ngjyrimet etnike. Prania e plisit në poezinë e Hamitit ka peshën dhe rëndësinë e veçantë, të ngjashme janë edhe figura të tjera që karakterizojnë portretin dhe ambientet shqiptare, si buka, shqiptarja, flamuri, shqiptari etj.

Nacioni është tema që kryeson në poezinë e Hamitit diku më e theksuar e diku më pak, por marrë në përgjithësi prania e nacionit jep idenë e mbështjellësit poetik në poezinë e Hamitit. Ky mbështjellës në frymën e pranisë së temës shqiptare si poetikë përveç që konkretizon temën jep edhe figuracione të reja, të cilat bëhen tema e që më herët nuk gjenden aq të shprehura në poezi të autorëve të tjerë. Kjo karakteristikë në poezinë e Hamitit poetikës shqiptare i fal figuracionin e vet autentik - plisin, si identifikim i shqiptarit dhe figura të tjera me të njëjtën temë, duke u shtrirë në rrethana të njëjta edhe në nivelin estetik “*e flamur mbeti veç një plis*”³⁰⁰ “*Shqiptarja nuk vret shqiptarë*”³⁰¹, “*Kunorë je përmbi plis*”.³⁰²

Veçantia në poezinë e Hamitit përcillet shpesh me një gegërishte duke i qëndruar besnik fjalës së shkruar e të folur me zërin e poetit që poezinë e ndien më shumë si gegë. Kjo natyrë shkrimi e poezisë së Hamitit dokumentohet më së shumti me poezinë “*Paskajorja*”, një himn i poezisë për gegërishten: “*Me shkue me shkue krejt njsioj asht me shkue / Në Prizren me shkue a me shkue në Shkodër / Me shkue në Durrës a në Tiranë me shkue / Në Vlorë me shkue a me shkue në Korçë / Me shkue në Elbasan a në Shkup me shkue / Me shkue do me thanë me vdekë pak nga pak*”.³⁰³

Në poezinë “*Paskajorja*” Hamiti kthen gegërishten si dialekt që i rri aq bukur poezisë. Këtë temë e trajton duke nënvizuar pikat kryesore të vendeve dhe kulturës shqiptare. Sabri Hamiti është mjeshtër i madh i formës së vargjeve. Teknika e shkrimit të vargut në poezitë e Hamitit diku delsi monokolonë, diku si tercinë, katrenë etj. Secili lloj i strofave nuk është i vendosur rastësisht në poezinë e S. Hamitit, është shumë i qëllimshëm, pasi secila poezi lidhet me kuptimin e këtyre llojeve të strofave. P.sh. te poezia “*Të humburit*” ku nga vetë titulli kuptojmë që është fjala për një temë të dhimbjes personale e kolektive, e cila për nga emocioni shkon kah vajtimi, në përputhje me të kemi edhe vargun e kësaj poezie, distikun, i cili qysh në antikë njihet si varg i vajtimit.

Hamiti në librin poetik “*Sympathia*” shfrytëzon teknikën e shkrimit të poezisë në prozë, këtë teknikë e ka të praktikuar në poezinë “*Shqiptari*”: “*Nëse ke nevojë më thirrë në telefon...*”.³⁰⁴ Teknika tjetër është kur përmes vargjeve arrijn të ndërtojë një imazh të caktuar, që pak a shumë njihet si poezi imazhiste. Poezia “*Sorrat*” jep një prerje të vargut në secilin përfundim të tercinës, duke zvogëluar rrokjet deri në vargun e fundit, që si kuptim dhe pamje shihet e ndihet se diçka është duke shkuar drejt humbjes, përfundimit, vdekjes. Pra, këto vargje që thyhen dhe vijnë duke u zvogëluar (rënë) japin idenë pamore se diçka është duke u shuar:

³⁰⁰ Hamiti, Sabri, *Sympathia Testament për Urtakun*, Faik Konica, Prishtinë, 2004, f. 12.

³⁰¹ Po aty, f.24.

³⁰² Po aty, f.28.

³⁰³ Po aty, f.40.

³⁰⁴ Po aty, f.66.

*“Koha po shtrembëron
Në Prishtinë
Terr”*³⁰⁵

Poezia e Hamitit është model artistik që mund të shkruhet vetëm nga një poet me kulturë të madhe letrare.

Ramadan Musliu “Në zemrën e gjërave” (2005) - “Në zemrën e gjërave”
RamadanMusliu krijon lidhjen me lexuesin nëpërmjet poezisë në vetën e parë në pjesën dërmuese, pa tonalitete deklarative. Pra, në këtë libër mungesa e pranisë së vargut deklarativ i jep vlerë vargut të Musliut, duke mos u ndier poezia e tij si lajm ditor, gjë që krijon mundësinë në jetëgjatësinë e vargut. Shihet se poezia e Musliut është reflektim i personale tek universalja ku kjo shkrimje bëhet pa jehonë dhe zëra të zhurmshëm.

Poezia “*Këngë burri*” jep ogurin e keq duke shkallëzuar forcat njerëzore përballë njeriut të pafat dhe pa forcë, për të dhënë temën e atdheut me shkrimin e poezisë si abstrakt përcjellë me stilin unik pa zëra të zhurmshëm: “*Ata i qepin lëkurën / derisa ai vetë qep / ëndërrat e bëra copë-copë / nga gërshërët e nostalgjisë / për barkun e nënës*”.³⁰⁶

Ndarja e përmbledhjes “*Në zemrën e gjërave*” ka këtë renditje: “*Andrra e jetës*”, “*Rrethi i mbyllur*”, “*Natyre e vdekur*”, “*Gjendje asnjënjese*”, “*Ëndërr rurale*”, “*Bardhë e zi*”, “*Këngë burri*”, “*Pika e shkrimje*”, këto ndarje kanë një kronologji në përcaktimin e temave që pak a shumë janë të përafërta. P.sh. po të ndalemi në ciklin “*Bardhë e zi*” poezitë që derivojnë në këtë cikël janë poezi që përshtaten shumë me emërtimin e ciklit dhe tema nënkuptohet që nga ky emërtim, këto poezi japin dëshpërimin dhe vijën shpirtërore që frymon si ndjesi e keqe: “*Fati i keq*”, “*Rrugë qorre*”, “*Darkë qençe*”, “*Vrima e zezë*”, “*Rrugë e shkurtër*”, “*Bardhë e zi*”, poezi këto që krijojnë një atmosferë të zymtë shpirtërore duke shpërfaqur gjendjen shpirtërore të njeriut në krizë. Prandaj, “*Në zemrën e gjërave*” gjërat thuhet me zemër.

Sali Bashota “Bukuri e nëmur” (2006) - Sali Bashota poeti që shkroi librin poetik “Bukuri e nëmur” në një dimension që natyrshëm nuk mund të shqitet nga tema e luftës në Kosovë gjatë viteve ‘99 duke pasur parasysh se përmbledhja poetike e tij është e shkruar nga viti 1999 deri në vitin 2005. Idetë e motivet në poezinë e Bashotës nuk janë të huajtura, janë nga përjetimet personale të tij gjatë kësaj periudhe e që si temë shtrihen edhe në përjetime dhe situata kolektive. Tema e atdheut dhe tema e luftës ‘99 në Kosovë te Bashota përfshin pothuajse tërë librin poetik: “*Atdhe domethënë Qielli / Vaji pikonte deri në gjunjë / Dhe kulmi i shtëpisë sëç rrënohej / Kur vallëzonin lebetitë*”.³⁰⁷

Temat, motivet dhe imazhet e luftës në poezinë e Bashotës më shumë janë koncentruar te poezitë “*Poezi e djegur*”, “*Duke harruar vetveten*”, “*Përmasat e kohës*”, “*Ikja nga vendlindja*” etj., në të cilat poezi paraqitet një tablo historike për vitet ‘98 - ‘99, si kujtime të trishta dhe sekuenca të rënda jetësore, që vijnë herë si të kujtuara, e herë si përjetime aktuale. Në këto poezi situatat janë sa personale aq edhe kolektive. Te poezia “*Përmasat e kohës*” Bashota në mënyrë vizuale prodhon profilin e mërzisë së kësaj kohe: “*Prapë ëndërrat vallëzojnë/Në katundin e djegur/ Dhe fytyra plaket nga mërëzia*”.³⁰⁸ Disa prej këtyre poezive shpesh arrijnë të përafrohen me tipin e dokumentarit artistik, si dëshmi faktike. Dokumentar në vete është edhe poezia e shkruar më 2 gusht 1998, ku ushtria ia djeg poetit shtëpinë, bibliotekën dhe dorëshkrimet:” ...digjej dhoma ime shtëpia prej guri biblioteka e shpirtit”.³⁰⁹

³⁰⁵ Po aty, f. 45.

³⁰⁶ Po aty, f. 77.

³⁰⁷ Bashota, Sali, *Bukuri e nëmur*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006, f. 13.

³⁰⁸ Po aty, f. 42.

³⁰⁹ Po aty, f. 81.

Ngjyrim të veçantë poetik poezisë së Bashotës i japin fjalët *vetmia, vdekja, loti, shiu*, të cilat, të pranishme në këtë libër, dalin herë si tituj e herë si tekst i inkuadruar në varg. Të gjitha këto janë figura që japin në variante dhimbjen, duke i dhënë vargut të këtij poeti një linjë të hollë të gjendjes shpirtërore të subjektit, që është edhe e kolektivit, si te “*Një vetmi & Një vdekje*”: “*Çdo natë nga kafshimi i bukurisë / Shtohen thinjat në kokë / Si trandafila të egër / Dhe bëhen plagomë e bardhë*”.³¹⁰ Sali Bashota e ndien vargun duke i dhënë vulën estetike përvojës së tij dhe duke e shndërruar atë përmes poezisë në përvojë kolektive të përjetshme.

Basri Çapriqi “Zbutja e gjarprit” (2006) - Poezia e Bari Çapriqit përmbledhur në librin “*Zbutja e gjarprit*” jepet me maturi fjalësh, me motive që nisin si të vogla për t’u bërë tema të mëdha në poezi. Poezia e tij është poezi ku ndihet vargu e fjala artistike si peshë. “*Zbutja e gjarprit*” si titull na jep metaforën që rrumbullakos poezitë e shkruara në këtë botim të vitit 2006. Çapriqi i ofron lexuesit poezinë si estetikë, si kuptim, si mesazh dhe si gërshetim të fjalës së popullit me ndjesinë personale të një poeti: “*Balta nuk është më / Si mjalti Atdheu / Do pak kripë / Nuk e hanë më këtë gjellë / Shpendët që kanë ku t’mbyen*”.³¹¹

Shprehimisht tema e luftës e viteve ‘99 nuk ndihet shumë e hapur te Çapriqi. Do me thënë jo që s’është përmendur si temë por intonacioni dhe estetika e vargut i jep më shumë vlerë universale me qëllim që të dalë përtej nacionales: “*Në fillim e pak vështirë / Ke dilemma / Sidomos mbi fëmijët / kur shkelin mbi fëmijët / Pastaj përkrah luftën dhe / Thërret vargje heroike*”.³¹² Në disa raste tema e luftës ka një tjetër natyrë shkrimi, atë të rrëfimit të saj të ndodhur më herët që tash poeti si narrator nga një situatë e qetë evokon kujtimet e kohës së shkuar: “*Unë jam frikësuar si qeni / Kur shihja nga dritarja si mprehnin thikat / Si ripnin lepujt*”³¹³ Këto poezi - rrëfime ndihen pothuajse në gjithë librin “*Zbutja e gjarprit*” duke krijuar vargun poetik me figuracione e ndjeshmëri që sillen brenda temës së luftës në nivel tjetër shkrimi.

Poezia e parë “*Guaca*”, që i paraprinë librit, është një poezi që shfaq sinopsisin për librin “*Zbutja e gjarprit*” si projekt dhe tërësi poetike: “*Sa kohë u bë që jemi mbyllur / Humbur brenda o zot / E s’dëgjojmë zërat e ujit*”.³¹⁴ Kjo teknikë shkrimi me një stil krejt të veçantë nga poezia tradicionale i jep një stil dhe veçanti vargut të Çapriqit, duke e bërë të identifikueshëm në poezinë e shkruar të kësaj periudhe.

Halil Matoshi “Hija e Krishtit” (2004) – Poetikën e Matoshit e shquan gjuha e drejtpërdrejtë, mbështjellë nga një figuracion i lehtë. Ky komunikim është i gjallë i ndier dhe shpirtëror që hijeshohet nga figuracioni ndërliidhur me ndjeshmëri, ashtu siç mund të shihet në poezitë e tij.

Është brilante mënyra se si e shkruan në gjashtë variante poezinë “*Sh’pia*”. Kjo poezi e veçantë e Matoshit përçon mesazh të fortë dhe ndihet fuqishëm sidomos në variantin e tretë të “*Sh’pia*”: “*midis tokës dhe qiellit oxhaqe herake / larg mbi mjegull tymi / thurr legjendat ballkanike*”.³¹⁵ Variantet e poezisë “*Sh’pia*” nisin prej datës 23 nëntor 1998 deri më 5 dhjetor 1998, duke reflektuar me fakte e dëshmi luftën që bëhej në Kosovë gjatë kësaj kohe. Krahas poezive të tjera të këtij autori, që temën e luftës e kanë si evokim kujtimesh të ndodhive të luftës të viteve 1999, gjashtë variantet e “*Sh’pia*” shihet se janë shkruar gjatë asaj periudhe, do me thënë në kohën e përjetimeve të këtyre situatave. Një komunikim poetik shumë miqësor e popullor, një dëftim i njeriut në një situatë, një sekuencë imazhesh të përjetuar në momentin që është duke e shkruar.

³¹⁰ Po aty, f. 24.

³¹¹ Çapriqi, Basri, *Zbutja e gjarprit*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006, f. 73.

³¹² Po aty, f. 78.

³¹³ Po aty, f. 76.

³¹⁴ Po aty, f. 7.

³¹⁵ Matoshi, Halil, *Hija e Krishtit*, SHESHI, Prishtinë, 2004, f. 201.

Pjesa tjetër epoezive në *“Hija e Krishtit”* janë poezi kushtuese: “N’Kosovë qyqja nuk vajton” (Ajshe Gërvalla), poezi kushtuar poetit Visar Zhiti, poetit AliPodrimja, EsatMekulit, Azem Shkrelit, gazetarit Afrim Maliqit etj. Shënjimi i këtyre poezive përkundër që është përkushtues është edhe rrëfim i situatave të caktuara në kohë lufte, është dëshmi e një realiteti dhe një situatë që kthehet në poezi. Poezia e Halil Matoshit është një mënyrë e të shkruarit që estetikën e gjen në popull dhe nuk shqitet nga masa.

Osman Gashi “Lumenjtë qiellorë”(2004) - Përmbledhja me poezi e Osman Gashit *“Lumenjtë qiellorë”* zhvillon komunikimin me lexuesin duke nisur librin e tij me poezitë: “Zog nate”, “Kornizat e kujtesës”, “Ku do të jesh”, “Purgatori ynë”, “Gjeografi shqiptare”, “Një Zot e di”, “Eklips” e poezi të tjera, të cilat krijojnë një bashkësi unike për të njohur e identifikuar poezinë e Gashit. Poezia e tij na del e ndarë në dy faza: para dhe pas luftës së viteve 1999 në Kosovë.

Tema dominuese në këtë vepër poetike me veshje figurative na del tema e atdheut diku si zë më i gjallë e diku si shpërfaqje e dhembjes shpirtërore për të: *“Sonte ka shumë krisma / Shie shumë / Qielli assesi të zbardhet”*³¹⁶. Poezia *“Thirra Kosovë”* është ndërtuar mirë në anën figurative, po ashtu, i rri mirë tema e ndërtuar në formë shumë origjinale. Figuracioni i shprehur në të për Kosovën si vend me *lisa rrënjëthellë e erëra që s’prajnë* përmbledhin historinë e tij në figura që bartin thellësi njohje e mendimi: *“Thirra: Kosovë! / Një lumë fjalësh / Që grumbullojnë / erëra që s’prajnë / Lisa rrënjëthellë / Që s’tunden”*.³¹⁷ Të kësaj natyre janë edhe poezitë: *“Krisma”, “Amulli”, “Ëndërra e Gentit”, “Poezia pritët të shkruhet”, “Lektisje”* etj., të cilat servohen si copëza përjetimesh të situatave nga vitet e luftës në Kosovë.

Poezia e Gashit lehtas interferohet si e shkruar edhe pas viteve 2000 duke i vënë ‘kapakun’ me poezitë *“I AM Happy”*, me situatë që përfundon me *“heppyand”*. Në këto poezi jepet një pikturë poetike ndryshe nga poezitë e luftës, këtu shihet shpresa, entuziazmi dhe loja e fjalëve me atmosferë të ndryshuar tashmë që reflekton lumturinë dhe pozitivitetin: *“Britmat / Drithmat / Grimcimet e thonjve / Në fushëgropë dhe... / Krismat, krismat, krismat / I shporre tej / Kur hapin e parë bërë / Brenda portës me dritë”*.³¹⁸

Libri *“Lumenjtë qiellorë”* është një metaforë si rrjedhje e jetës që del përmes fjalës *“lumenjtë”*, ndërsa fjala *“qiellorë”* na del ndërlidhshëm me kushtet atmosferike që krijohen nga qielli si reflektues të gjendjes shpirtërore të njeriut dhe rrethanave të jashtme të tij, si metaforë për jetën në tokë.

Naime Beqiraj “Njomja e fikut” (2009) - NaimeBeqiraj është një prej zërave të veçantë në poezinë shqipe të Kosovës. Poezitë e Beqirajt përveç figuracionit kanë tonalitete të mëdha feminizmi si karakteristikë që veçojnë stilin në shkrimet e saj. Trajtimi i temave në poezinë e saj lartëson femrën si qenie njerëzore duke vënë në pah përveç anës intelektuale edhe atë estetike. Këtë e thotë më së miri në disa nga poezitë e saj te *“Njomja e fikut”*: *“Lyerja”, “Qepallat e lyera me blu”, “Femër”, “Qërpikët e mi”* etj.

Portreti i gruas te *“Njomja e fikut”* pothuajse është gjithëpërfshirës dhe karakterizues për poezinë e NaimeBeqirajt. Në këtë përmbledhje shpesh imagjinaria është e pranishme si zë femëror, për të imagjinuar situata të reja ku vendoset femra: *“Mendo sikur të gjithë kapitenët / Të ishin femra / Dhe në çast pushimi / Të peshkonin / Mbi shpinat tua do të trandin detin / Së largu / Po vijnë nimfat”*.³¹⁹

³¹⁶ Gashi, Osman, *Lumenjtë qiellorë*, Shtëpia Botuese Rozafa, 2004, f. 44.

³¹⁷ Po aty, f. 31.

³¹⁸ Po aty, f. 30.

³¹⁹ Beqiraj, Naime, *Njomja e Fikut*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, f. 28.

Këtë natyrë shkrimi e gjejmë të theksuar edhe në poezitë me tematikë dashurie: "...*Fshihemi në përralla për një mot të ri/ Pak si ëndërrueshëm, dorën të ta prek*",³²⁰ vargje këto që dalin nga poezia "Eshkë", si një metaforë që lidhjen tematike e kombinon mirë në këtë tip poezie. Në përmbledhjen "*Njomja e fikut*" poetja Beqiraj nuk ka mundur t'i ikë kohës dhe temës së luftës edhe në këtë libër me poezitë "Luftë", "Maket për Kosovën" etj. Poezia e Naime Beqiraj është zëri i femrës poete në Kosovë gjatë këtyre viteve.

Përfundim

Po e përmbyllim këtë temë me këtë lexim të poezive duke pasur parasysh se poezia e këtyre viteve është më pak e interpretuar dhe e eksploruar në kuptimin e analizave tekstuale. Pra, kemi parë se dhjetëvjetëshi i poezisë së Kosovës është përcjellë edhe me poezi të shkruara gjatë luftës dhe për luftën, përkundër që jemi në vitet 2000 vitet e pasluftës në Kosovë. Nacioni në poezinë e Kosovës është pika dalluese që e veçon pothuajse tërë poezinë e shkruar në vitet 2000 mbi ndërtimin e temave të mëdha: atdheu, lufta, paqja, dashuria etj.

Jemi ndalur te disa autorë për të njohur poezinë e tyre gjatë këtyre viteve dhe për të parë se si këta autorë të cilët kanë shkruar edhe para viteve 2000 kontekstit i japin ngjyrim të madh estetik, po ashtu krijojnë figura etnie në poezi për t'i dhënë identitet poetikës shqiptare. Nga e gjithë kjo del se poezia e viteve 2000 - 2010 në Kosovë është poezia që frymon si identitet me vlera të larmishme poetike.

Referencat

- [1]. Dedaj, Rrahman, *Vepra letrare 3*, Faik Konica, Prishtinë, 2008.
- [2]. Podrimja, Ali, *Libri mbi të qenit*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2009.
- [3]. Halimi, Nexhat, *requiem për fluturën*, Qendra e Kulturës, Podujevë, 2004.
- [4]. Hamiti, Sabri, *Sympathia Testament për Urtakun*, Faik Konica, Prishtinë, 2004.
- [5]. Musliu, Ramadan, *Në zemrën e gjerave*, Gjon Buzuku, Prishtinë, 2005.
- [6]. Bashota, Sali, *Bukuri e nëmur*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006.
- [7]. Çapriqi, Basri, *Zbutja e gjarprit*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2006.
- [8]. Matoshi, Halil, *Hija e Krishtit*, SHESHI, Prishtinë, 2004.
- [9]. Gashi, Osman, *Lumenjtë qiellorë*, Shtëpia Botuese Rozafa, 2004.
- [10]. Beqiraj, Naime, *Njomja e Fikut*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2009.

³²⁰ Po aty, f. 7.